

## AKT THEMELIMI

i Shoqërisë “Factory31” Sh.p.k

Sot me datë 01.07.2022, Z.Klitjan Shorja i lindur në Elbasan, mbajtës dhe i identifikuar prej kartës së identitetit me nr. 032176446 dhe nr Personal (NID) J40828008L, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Z. Ervin Meçaj i lindur ne Tirane, mbajtës dhe i identifikuar prej Pashaportës me nr. BA3904667 dhe me nr. Personal (NID) H21021075V madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shprehin vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “Factory31” sh.p.k si më poshtë vijon:

### 1.FORMA LIGJORE

“Factory31”, është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

### 2.ORTAKËT THEMELUES

Ortakët e shoqërisë janë Z.Klitjan Shorja i lindur në Elbasan ,mbajtës dhe i identifikuar prej kartës së identitetit me nr. 032176446 dhe nr Personal (NID) J40828008L dhe Z.Ervin Mecaj i lindur ne Tirane, mbajtës dhe i identifikuar prej pashaportës me nr. BA3904667 me nr. Personal (NID) H21021075V.

### 3.OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është :

-Prodhim, prerje dhe qepje faqe kepecësh, prodhim kepecësh e sandalesh,veshje këmbë ne tërësi, kryesisht me përpunim aktiv fason. Prodhime artizanale dhe industriale,tregëtim brenda dhe jashtë vendit. Import-eksport.Tregëti me shumicë e pakicë te artikujve të ndryshëm industrialë,veshje kembe,materjale për prodhimin e veshjeve të këmbës.Transport mallrash për nevojat e veta. Tregëtim dhe prodhim i materialeve dhe lëndëve të para brenda dhe jashtë vendit.Tregëtim prodhimesh të ndryshme.Import-eksport të produkteve dhe mallrave të ndryshëm si dhe reklamës dhe promocionit për nevoja të veta dhe ndaj të treteve,si dhe cdo aktivitet i lejuar dhe rregulluar me ligj,pasi të jetë pajisur me leje përkatëse.

### 4.SELIA

- 4.1 Selia e shoqërisë është në Lagjja “Hekurudha”, Nr.Pasurie:20/515 Zona Kadastrale nr.8523 Elbasan
- 4.2 Ortakët mund të vendosin hapjen e filjaleve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të Shqipërisë.

### 5.KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj sipas objektit, për një periudhe kohore të pakufizuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

5.2 Afati i përmendur në pikën 1 te këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakëve themelues të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti.

## 6.KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “100,000”.

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota dhe secila prej tyre e ka vlerë 50,000 leke.

6.2 Sipas kontributit të mësipërm ortakëve u përkasin respektivisht:

- 1 kuotë **Z.Klitjan Shorja** 50.000 (pesëdhjetëmije) lekë ose 50% të kapitalit.

- 1 kuotë **Z.Ervin Mecaj** 50.000 (pesëdhjetëmije) lekë ose 50% të kapitalit.

6.3 Çdo pjesë përfaqëson të drejtën e një vote.

6.4 Kapitali themeltar do të derdhet nga secili ortak në llogarinë bankare të shoqërisë e cila do të hapet menjëherë pas regjistrimit të saj

## 7.DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria drejtohet nga Administratori. Administratori i parë i shoqërisë është

**Z. Klitjan Shorja.**

Administratori emërohet për një afat 5- vjeçar .

## 8.SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor duke përfshirë falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore dhe çdo faktor tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

## THEMELUESIT

**Klitjan Shorja**  


01.07.2022

**Ervin Mecaj**  
